

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 2 (dy) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Rektoratit për pozicionet si më poshtë:

A. Kriteria të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Specialist i Sektorit të Botimeve Shkencore në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.

- a) Të zotërojë diplomë të Universitare Master Profesional ose Master Shkencor në një nga fushat e arsimit të lartë.
- b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Specialist i Sektorit të Botimeve Shkencore.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

B. Kriteria të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Specialist për Koordinimin në Sektorin e Koordinimit dhe Partneritetit, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit.

- a) Të zotërojë diplomë të Universitare Master Profesional ose Master Shkencor në një nga fushat e arsimit të lartë.
- b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune.
- c) Të zotërojë një gjuhë të huaj të vërtetuar me dëshminë përkatëse.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Specialist për Koordinimin.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **21.05.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.